



Prishtinë, 10 dhjetor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1331_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Balanceve të Energjisë; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 5 nëntor 2020, për miratimin e dokumentit: Bilanci Afatgjatë të Energjisë Termike 2021-2030.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 10 dhjetor 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET BILANCI AFATGJATË I ENERGISË TERMIKE për periudhën 2021-2030 i NP Termokos sh.a.**

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2021-2030 nga NP Termokos sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
 2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2021-2030" të dorëzuar nga NP Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2021-2030" në faqen elektronike zyrtare të tij.**
- III. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.**



- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
- VI. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Arsim Janova, UJ Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike – 2021-2030, NP Termokos

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së